



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 157

Tiranë – E enjte, 18 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9724, datë 16.8.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11947
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11, datë 30.6.2016	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë..... 11947
Urdhër i ministrit të Energjisë dhe Industriës nr. 258, datë 3.8. 2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar..... 11947
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 108, datë 16.8.2016	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmërore të Partisë Demokratike në qarkun Dibër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të heqjes dorë nga mandati, të deputetit z. Sherefedin Shehu..... 11950
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industriës nr. 1048/10, datë 15.7.2016	Për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme, të tipit “arë”, që preket nga “Ndërtimi i nënstacionit 110 kv Orikum dhe nënstacionit 110 kv Himarë”..... 11951
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industriës nr. 1943/13, datë 15.7.2016	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme, të tipit “arë”, “kullotë”, “pyll”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv Ulëz– Shkopet–Skuraj”..... 11952
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4400/5, datë 10.8.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i galerisë për kabllot e rrjetit shpërndarës të n/stacionit qendër 110/20 kv”..... 11952
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4493, datë 10.8.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Unaza 1 Maj”, Himarë”..... 11953

Kërkesë Ministrisë së Zhvillimit
Urban nr. 4505, datë 11.8.2016

Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë
private, që preken nga realizimi i projektit “Shëtitorja Qeparo loti 2” +
“Shëtitorja Qeparo loti 1”, Himarë..... 11954

Vendim *i shkurtuar* për shpalljen të vdekur të shtetasit Mihallaq Doko... 11955

**DEKRET****Nr. 9724, datë 16.8.2016****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e Ministrit të Arsimit dhe Sportit

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Labinot Faruk Ibrahim
2. Ylber Latif Ramadani
3. Mentor Xhemajl Mazrekaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM**Nr. 11, datë 30.6.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
NR. 52, DATË 3.12.2015, “PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË
GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET
NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 76 dhe të pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 9 të udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

“9/1 Certifikata, diploma apo dëshmia e lëshuar nga subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas konfirmimit të secilit dokument nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për testin përkatës, sipas tabelës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.”.

2. Pika 10 e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, shfuqizohet.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbi-meve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla**

URDHËR**Nr. 258, datë 3.8. 2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHHRIN NR. 83, DATË 10.2.2012,
“PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E SHITJES SË PRODUKTEVE
HIDROKARBURE (NAFTË BRUTO)”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 1 të aktit normativ nr. 2, datë 18.6.2010, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 10298, datë 8.7.2010; të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedimet e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



1. Pika 1 riformulohet:

“1. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos është përgjegjëse për shitjen me ankand me anën e procedurës së hapur të produkteve hidrokarbure, me qëllim:

- përpunimin dhe/ose eksportimin e produktit hidrokarbur naftë bruto, sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar;

- tregtimin dhe transportimin e produktit hidrokarbur gaz natyror për furnizimin e konsumatorëve fundorë dhe ose për eksport, sipas dispozitave të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror.”.

2. Pika 2 riformulohet:

“2. Procedura e shitjes së produkteve hidrokarbure do të fillojë, kur shoqëria të ketë:

- të depozituara 20 000 (njëzet mijë) deri në 30 000 (tridhjetë mijë) tonë produkte hidrokarbure (naftë bruto), pavarësisht se kjo sasi është krijuar nga vetë prodhimi i shoqërisë apo nga përfitimi që shoqëria merr nga marrëveshjet hidrokarbure (prodhimi paraekzistues dhe pjesa e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos). Mbas krijimit të kësaj sasive, në sasinë e produkteve hidrokarbure që do të shiten mund të përfshihen dhe sasi të produkteve hidrokarbure që parashikohen të prodhohen nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. apo nga përfitimi që shoqëria merr nga marrëveshjet hidrokarbure gjatë një periudhe jo më të madhe se një vit;

- të përcaktuara në programin e zhvillimit për vitin në vazhdim dhe për 5 vitet pasardhëse, sasitë e gazit natyror dhe/ose gazit shoqërues që do të disponojë për tregtim.”.

3. Pika 3 riformulohet:

“3. Me krijimin apo përcaktimin e sasisë së produkteve hidrokarbure, në përputhje me pikën 2 të këtij urdhri, titullari i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos, njofton Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI), si dhe pret miratimin e saj për fillimin e procedurës së shitjes. Pas miratimit nga MEI, titullari i shoqërisë nxjerr urdhrin për shitjen me ankand me anën e procedurës së hapur të këtyre sasive të produktit hidrokarbur naftë bruto apo gaz natyror.”.

4. Në pikën 4 paragrafi i parë riformulohet:

“- sasia e produkteve hidrokarbure naftë bruto apo gaz natyror, që do të shitet;”.

5. Pika 5 riformulohet:

“5. Shitja e produktit hidrokarbur naftë bruto për tregun vendas me qëllim përpunimin e tyre dhe/ose për eksport, do të bëhet sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për naftën bruto (Bursa Ndërkombëtare “Brent”).

Shitja e produktit hidrokarbur gaz natyror për tregun vendas dhe/ose për eksport do të bëhet sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për gazin natyror (Bursa Ndërkombëtare “TTF - Title Transfer Facility”).

Për rastet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes së sasive të gazit natyror që do të shiten nëpërmjet sistemeve të transmetimit apo të shpërndarjes, të cilët janë pajisur me licencat përkatëse nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), shoqëria “Albpetrol” sh.a. duhet të publikojë edhe tarifat e transportimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror në këto rrjete, sikurse janë miratuar nga ERE.”.

6. Pika 6 riformulohet:

“6. Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes së produktit hidrokarbur naftë bruto, përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për brentin, në momentin e përllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi, sipas cilësisë së produktit të prodhuar dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes.

Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes së produktit hidrokarbur gaz natyror përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për “TTF - Title Transfer Facility”, në momentin e përllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi, sipas cilësisë së produktit të prodhuar dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes.

Në rast se çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes së produkteve hidrokarbure rezulton më i ulët se çmimi i shitjes i programuar nga “Albpetrol” sh.a. për vitin përkatës, ky çmim miratohet paraprakisht nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë, si dhe vihet në dijeni MEI.”.

7. Mbas fjalisë së parë të pikës 7, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Për sasitë e produkteve hidrokarbure që ndodhen në shtresë, do të merren në konsideratë të dhënat historike të prodhuara nga vendburimet historike”.



8. Në pikën 11 paragrafi i katërt riformulohet:

“Në ankandin publik lejohen të marrin pjesë ofertues/kandidatë, që i kanë tërhequr dokumentet drejtpërdrejt nga autoriteti shitës, si dhe ata që i kanë tërhequr këto dokumente në rrugë elektronike, të cilët duhet të jenë të pajisur:

- me licencë koncesioni për përpunimin e produktit hidrokarbur naftë bruto në tregun e brendshëm ose me licencën përkatëse për tregtimin e këtij produkti hidrokarbur, të marrë në Shqipëri, sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, kur këto produkte do të përpunohen ose tregtohen në Shqipëri;

- me licencën përkatëse të marrë në Shqipëri, sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar ose në vendin e origjinës së shoqërisë, për tregtimin e produktit hidrokarbur naftë bruto, kur këto produkte do të tregtohen për qëllim eksporti;

- me licencën përkatëse të marrë në Shqipëri nga ERE, sipas dispozitave të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, për tregtimin ose furnizimin e produktit hidrokarbur gaz natyror për tregtim te konsumatorët vendas ose për qëllim eksporti.”.

9. Në pikën 12, paragrafi i dytë, pas pikës “ii” shtohet pika “iii” me këtë përmbajtje:

“iii) të dhëna mbi kushtet e kontratës së shitjes për rastin e ankandit të shitjes së produktit hidrokarbur, naftë bruto dhe gaz natyror, e cila do të lidhet ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos dhe ofertuesit fitues të ankandit.”.

10. Në pikën 12, paragrafi i gjashtë riformulohet:

“- Informacioni specifik përfshin:

- a) specifikimet teknike të produkteve hidrokarbur naftë bruto apo gaz natyror;

- b) grafikun e zbatimit të kontratës për shitjen e produkteve hidrokarbur naftë bruto apo të gazit natyror;

- c) afatin përfundimtar të ekzekutimit të kontratës së shitjes së produktit hidrokarbur naftë bruto;

- d) kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.”.

11. Në pikën 16/a, paragrafi i tretë riformulohet:

“Kontrata e shitjes, ndërmjet kushteve të tjera, duhet të përfshijë detyrimisht, të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas kontratave tip për shitjen e naftës bruto dhe për gazin natyror, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.”.

12. Në pikën 17 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kontratat për shitjen e produktit hidrokarbur gaz natyror, për shkak të natyrës së veçantë të produktit, të kenë një kohëzgjatje jo më të shkurtër se 5 (pesë) vjet. Në rast se shitësi nuk arrin të furnizojë blerësin me sasinë totale vjetore të gazit natyror, shitësi duhet t’i dërgojë një njoftim blerësit, ku të paraqesë shkaqet që justifikojnë pamundësinë e livrimit të sasisë vjetore të planifikuar. Palët kanë të drejtë që të negociojnë në mënyrë që sasi të e palivruara për një vit, të plotësohen në vitin pasardhës, në rast se kjo është e mundur.”.

13. Në pikën 22, paragrafi i dytë riformulohet:

“Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos njofton autoritetin doganor dhe tatimor, si dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Entin Rregullator të Energjisë (ERE) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), për çdo shitje të produkteve hidrokarbur, naftë bruto apo gaz natyror, brenda vendit apo për eksport.

Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos kërkon konfirmimin nga autoriteti doganor dhe tatimor për sasinë e produkteve hidrokarbur, naftë bruto apo gaz natyror të eksportuara.”.

14. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në MEI.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjijnuri

**VENDIM****Nr. 108, datë 16.8.2016**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT
KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE NË QARKUN DIBËR,
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË, PËR SHKAK TË HEQJES
DORË NGA MANDATI, TË DEPUTETIT
Z. SHEREFEDIN SHEHU**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 16.8.2016, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi	kryetare
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Dibër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Sherefedin Shehu.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza Ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a” dhe neni 164, neni 175, pika 2, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 2496/2 prot., datë 15.8.2016, drejtuar KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Sherefedin Shehu, deputeti i zonës zgjedhore, qarku Dibër.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës

parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 34, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Dibër, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore, qarku Dibër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 3 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun e Dibër, janë: kandidati me numër rendor 1 (një), z. Sherefedin Shehu; kandidati me numër rendor 2 (dy), z. Bedri Hoxha; kandidati me numër rendor 3 (tre), z. Roland Keta.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun e Dibër nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë, kandidat nga secila gjini. KQZ-ja me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013 vendosi sanksionin administrativ, gjobë në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Demokratike. Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore, qarku Dibër, duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për punësim, mirëqenie dhe integritet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të partisë.

Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet, sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 për vendet, sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore, në listën shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun Dibër, kandidatja e renditur e para dhe e fundit nga gjinia më pak e përfaqësuar, është kandidatja me numër rendor 6 (gjashtë), znj. Dhurata Bajram Çupi.

Referuar nenit 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,



vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave, në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte, znj. Dhurata Bajram Çupi, duhet të depozitojë formularin e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, deputet i Kuvendit.

Znj. Dhurata Bajram Çupi Leka, me shkresën nr. 3086, datë 15.8.2016, i ka dërguar KQZ-së formularin e vetëdeklarimit.

Në zbatim të nenit 11, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja duhet të bëjë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit dhe verifikimin e të dhënave në këtë formular.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Dhurata Bajram Çupi, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në këto kushte, KQZ-ja, referuar kreut V, pikës 2, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, duhet të marrë vendim për dhënie mandati, znj. Dhurata Bajram Çupi, si dhe njëkohësisht të vazhdojë procedurat e mëtejshme për realizimin e verifikimit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, pika 2, nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Dibër, znj. Dhurata Bajram Çupi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KËRKESË

Nr. 1048/10, datë 15.7.2016

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik, të pasurisë së paluajtshme, të tipit “arë” që preket nga “Ndërtimi i nënstacionit 110 kv Orikum dhe nënstacionit 110 kv Himarë”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për pronarin e pasurisë nr. 1004/3, sipas tabelës bashkëlidhur.

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personi që ka emrin në listën emërore ka të drejtën të paraqesë pretendimet e tij, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

ZËVENDËSMINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Ilir Bejtja



**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110 kv
ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 kv, HIMARË**

Lloji i pasurisë së paluajtshme (tokë arë)

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësimit për nënstacionin m ²	Vlera e shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m ²				
Bashkia Vlorë											
Tragjas				3621							
1	Zenel	Gjoni	Zeneli	3621	1004/3	arë	5500	2563	204	522852.0	Me certifikatë pronësie
Sipërfaqja totale për shpronësim në m ²								2563			
Shuma totale në lekë për shpronësim										522852	

KËRKESË

Nr. 1943/13, datë 15.7.2016

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik, të pasurive të paluajtshme, të tipit “arë”, “kullotë”, “pyll”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv Ulëz–Shkopet–Skuraj”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për personat sipas tabelës bashkëlidhur.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

**ZËVENDËSMINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIËS
Ilir Bejtja**

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 KV R Ulëz, Shkopet, Skuraj
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: T Tokë "arë", "kullotë", "pyll"

Nr.	Numri I shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësimit t m ²	Cmimi I tokës Lek/m ²	Vlera e Shpronësimit ne Leke	Shënime	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji I Pasurisë	Sasia Sip pronës m ²					
Qarku Lezhe													
					3391								
1	19	Preng	Ndue	Malci	3391	122	Arë	6100	41.1	278	11425.8		
2	20	Bashkepronesi			3391	95	Pyll	3900	77	100	7700.0		
3	21	Pretendues			3391	167	Arë	1800	77	278	21406.0		
4	21A	Kurum International Sh.a			3391	154	Kullote	7900	77	117	9009.0		
5	22	Ndue Gjon Ndoka			3391	200	Pyll	5000	77	100	7700.0	Bashkepronesi	
6	31	Ndue Gjok Pergjoka			3391	240	Arë	1450	57.4	278	15957.2		
Sipërfaqe totale për shpronësimi në m ²									406.5				
Shuma totale në Lek për shpronësim												73198	

KËRKESË

Nr. 4400/5, datë 10.8.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i galerisë për kabllot e rrjetit shpërndarës të n/stacionit qendër 110/20 kv”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe

të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 98,355,494 (nëntëdhjetë e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Alfred Dalipi**



Llogaritjet paraprake për shpronësimin e pasurive që preken nga projekti "Ndërtimi i Galerisë për kabllot e Rrjetit shpërndarës të Nënstacionit Qendër 110/20 kv".

Nr	EMER MBIEMER	Zona Kadas t.	NR. Pasuris ë	Sipërf. Përgj. Tr./ m ²	SIP. Tr. të prekur / m ²	Çmimi për tr. m ²	Vlefte në lekë tr.	SIP. Obj. të prekur / m ²	Çmimi për obj. m ²	Vlefte në lekë obj.	Vlefte e pergjitheshme	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Bashkpr.Karaj, Malja, Çeliku	8360	6/194	355.92	202.00	66,969	13,527,738	0	0	0	13,527,738	Konfirmuar nga ZVRPP, Urdher kufizimi + ndertim pa leje
2	Bashkpr.Kore, Gjerazi	8360	6/222	85.20	85.20	66,969	5,705,759	0	0	0	5,705,759	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Sabire Jaup Kore	8360	6/158	84.4	84.40	66,969	5,652,184	0	0	0	5,652,184	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Bashkpr.Buli, Trebicka,	8360	6/192	338.5	338.50	66,969	22,669,007	96.5	40,019	3,861,834	26,530,840	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Bashkpr. Axha, Gëdeshi, Samarxhia (Çepunja)	8360	6/191	292.1	268.10	66,969	17,954,389	80	40,019	3,201,520	21,155,909	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Bashkpr. Axha, Gëdeshi, Samarxhia (Çepunja)	8360	6/244	40.00	40.00	66,969	2,678,760	0	0	0	2,678,760	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Shtet	8360	6/223	12.75	12.75	66,969		0	0	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP
8	I pa identifikuar	8360	6/248	0	0	66,969	0	0	0	0	0	Nuk ka informacion ZVRPP
9	Shtet,	8360	6/249	48.59	48.59	66,969	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP
10	GECI shpk.	8360	6/300	5800	70.00	66,969	4,687,830	0	0	0	4,687,830	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Bashkpr.Buneci	8360	6/193	472	37.00	66,969	2,477,853	0	0	0	2,477,853	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Bashkpr. Dashi, Pulaj, Hallulli, Skënderi, Piliñçi, Daka, Fortuzi, Durda dhe Vathi.	8360	6/216	179	98.00	66,969	6,562,962	0	0	0	6,562,962	Konfirmuar nga ZVRPP, Urdher kufizimi + ndertim pa leje
13	Iljaz Këllezi	8360	6/188	379	140.00	66,969	9,375,660	0	0	0	9,375,660	Konfirmuar nga ZVRPP, mbi pasurine ka ndertim te paligjshem
14	Shtet	8360	6/707	500.54	70.54	66,969	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP, ka kufizim
					1495.08	Shuma	91,292,141	176.5		7,063,353.500	98,355,494	Lekë

KËRKESË

Nr. 4493, datë 10.8.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës "Unaza 1 Maj", Himarë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashka Himarë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së

shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi, me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 2,033,528.60 (dy milionë e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë, pikë gjashtëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Gjon Radovani

Tabela e pronave që shpronësohen për interes publik në zbatim të projektit "Rikonstruksioni i rrugës Unaza 1 Maj, Himarë"

Nr.	Pronari		ZK	Nr. Pasurise	Lloji i pasurise	Sipërfaqia e truallit	Çmimi Lek/m2	Vlera truallit leke	Vlera objektit leke	Vlera e pasurise leke	Shenime
	Emer	Mbiemer					Truall				
1	Gogo	Naci	1952	3334	Pike karburanti	225	4350	978,750	1,054,778.6	2,033,528.60	Konfirmuar nga ZVRPP
								Vlera totale		2,033,528.60	

**KËRKESË****Nr. 4505, datë 11.8.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shëtitorja Qeparo loti 2” + “Shëtitorja Qeparo loti 1”, Himarë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Himarë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe

të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 4,160,957 (katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Alfred Dalipi**

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONËSIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "SHËTITORE QEPARO LOTI 2"

Nr	Mbiemri	Atesia	Emri	Lloji i pasurisë	Nr. Hipotekore/Pasurie	Zone Kadastrale	Sip. tokes që shpronësohet	Sip. objektit që shpronësohet	Vlera e objektit për shpronësimet në Lekë	Vlera e tokes për shpronësimet në Lekë	Vlera totale për shpronësimet = vlerë e ndertës	Vlera totale për shpronësimet = vlerë e tokës	Vlera totale për shpronësimet = vlerë e objektit + vlerë e tokës	Vendodhje
1			Shtet	Ranishte	108/81	3095								Qeparo fushe
2	Vogli	Nestur	Shulla	Ullishte	104/45	3095	453.05 m²			204 leke/m²		92422.2		Qeparo fushe
3	Mihallani		Spiro	Ullishte	108/80	3095	437.47 m²			204 leke/m²		89243.88		Qeparo fushe
4			Shtet	Rruge	108/86/1									Qeparo fushe
5	Koci	Niko	Mico	Ullishte	108/79	3095	447.99 m²			204 leke/m²		91389.96		Qeparo fushe
6	Kosta		Lefter	Truall/Ndertese	108/82	3095	467 m²	90 m²	16710 leke/m²	2135 leke/m²	1503900	997045	2500945	Qeparo fushe
7	Marku	Polo	Nestur	Ullishte	108/78	3095	326.09 m²			204 leke/m²		66522.36		Qeparo fushe
8	Reci	Niko	Koco	Ullishte	108/83	3095	582.73 m²			204 leke/m²		118876.92		Qeparo fushe
9			Shtet	Truall	110/86	3095								Qeparo fushe
10	Pali	Jani	Stefan	Ullishte	108/77	3095	266.54 m²			204 leke/m²		54374.16		Qeparo fushe
11	Dede		Vasillo + Armandhi + Kristo + Andrea + Kristianthi	Ullishte	108/84	3095	801.69 m²			204 leke/m²		163544.76		Qeparo fushe
12	Rrusha	Mico	Foto	Ullishte	110/78	3095	672.65 m²			204 leke/m²		137220.6		Qeparo fushe
13			Shtet	Ranishte	110/97	3095								Qeparo fushe
14	Foto		Theodhori	Ullishte	110/84	3095	898.37 m²			204 leke/m²		183267.48		Qeparo fushe
15	Qesari		Niko	Ullishte	110/83	3095	580.83 m²			204 leke/m²		118489.32		Qeparo fushe
16	Rrusha		Vasil	Ullishte	110/82	3095	226.20 m²			204 leke/m²		46144.8		Qeparo fushe
17	Hyso	Zaho	Polo	Ullishte	110/88	3095	1.212,28 m²			204 leke/m²		247305.12		Qeparo fushe
18			Shtet	Truall	110/87	3095								Qeparo fushe
19	Guma	Dhimiter	Leonidha	Ullishte	110/90	3095	457.92 m²			204 leke/m²		93415.68		Qeparo fushe
20			Shtet	Ullishte	110/91	3095								Qeparo fushe
21	Kokedhima		Aristidh	Are	117/3	3095	6.300 m²			204 leke/m²		1285.2		Qeparo fushe
23			Shtet	Truall	117/6	3095								Qeparo fushe
24			Shtet	Truall	117/1	3095								Qeparo fushe
25			Shtet	Truall	121/9	3095								Qeparo fushe
26			Shtet	Truall	121/11	3095								Qeparo fushe
27			Shtet	Truall	129/87	3095								Qeparo fushe

SHUMA = 4,004,447.44



TABELA E PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "SHETITORE QEPARO LOTI 1"

Nr	Mbiemer	Atesia	Emer	Lloji i pasurise	Nr. Hipotekore/P asurie	Zone Kadastrale	Sip. Tikes qe shpronesohet	Cmimi tokes per njesi sipas cmimit te shpronesimit	Vlera e tokes per Shpronesimet ne Leke	Vendodhje
1	Piro	Niko	Koci	Truall	105/48	3095	18,64 m ²	2135 leke/m ²	39.796.4	Qeparo
2	Aristotel	Duke	Todhri	Lloji Ullishte	104/47	3095	415.35 m ²	281 m ²	116.713.35	Qeparo
SHUMA=									156509.75	

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin numër 1271, datë 27.6.2016, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Mihallaq Doko, në datën 11.10.1991 (i biri i Themiut dhe i Vases, i lindur në Dëllenjë, Vlorë, në datën 2.10.1964).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë